



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2024:218744
Datë: 01.10.2024
Numri i dokumentit: 06234814

K.DH.SH.II.nr.1755/24

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryetar, Krenar Berisha dhe Dren Rogova anëtarë në çështjen juridike të Paditësit/Propozuesit të masës së sigurisë “Finart” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810088345 dhe seli në Prishtinë, rr. “Uran Ajeti”, nr. 2, kundër të Paditurës/Kundërshtares së sigurimit Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) me seli në Prishtinë, rr. “Migjeni”, kat 2, zyra nr. 6, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të masës së sigurisë e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomave të shkallës së parë-Departamenti për Çështje Ekonomike KE.nr.631/24 datës 27.08.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 25.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. **REFUZOHET** si e pabazuara ankesa e propozuesit të masës së sigurimit “Finart” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810088345 dhe seli në Prishtinë, rr. “Uran Ajeti”, nr. 2,.

II. **VËRTETOHET** Aktvendimit i Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.631/24 datës 27.08.2024.

A R S Y E T I M

Me aktvendimin e atakuar të Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike ka vendosur: “REFUZOHET në tërësi si i pabazuar propozimi i Propozuesit të masës së sigurimit “Finart” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit dhe t’i ndalohej të Kundërshtares së sigurimit Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) të bëjë ekzekutimin e polisave nr. 122365 dhe 122366 të datës 15.02.2024, për sigurimin e garancisë së ekzekutimit të tenderit “Shërbime të përkthimit dhe pajisje të zërimit për nevoja të IAP”, me numër të prokurimit 321-24-181-2-2-1, për llot I dhe II, nr. 119153.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankese propozuesi i masës së sigurimit, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata të aprovoj ne tersi ankesën si të bazuar, të anulohet aktvendimin e atakuar dh elenden te kthej ne rishqzrtim ne gjzkatene shkalles s epare spo të ndryshohet aktvendimi të atakuar dhe te aprovohet propozimi për caktimin e masës së sigurisë i paraqitur nga propozuesi ashtu qe t'i ndalohe të Kundërshtares së sigurimit Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) të bëjë ekzekutimin e polisave nr. 122365 dhe 122366 të datës 15.02.2024, për sigurimin e garancisë së ekzekutimit të tenderit “Shërbime të përkthimit dhe pajisje të zërimit për nevoja të IAP”, me numër të prokurimit 321-24-181-2-2-1, për llot I dhe II, nr. 119153, deri ne vendosje përfundimtare sipas aktgjykimit te formës prerë ne këtë çështje juridike.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesit/paditësit, në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar propozim për caktimin e masës së sigurisë me të cilën kanë kërkuar aprovohet propozimin e propozuesit te masës se sigurisë ndaj te paditures kundërshtareve te mase se sigurisë Caktohet Masa e sigurimit ndaj kundërshtarëve te sigurimit ashtu qe t'i ndalohe të Kundërshtares së sigurimit Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) të bëjë ekzekutimin e polisave nr. 122365 dhe 122366 të datës 15.02.2024, për sigurimin e garancisë së ekzekutimit të tenderit “Shërbime të përkthimit dhe pajisje të zërimit për nevoja të IAP”, me numër të prokurimit 321-24-181-2-2-1, për llot I dhe II, nr. 119153, deri ne vendosje përfundimtare sipas aktgjykimit te formës prerë ne këtë çështje juridike.

Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë- me aktvendimin e atakuar ka refuzuar si te pabazuar propozimin e masës se sigurisë “Finart” Sh.P.K., me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit dhe t'i ndalohe të Kundërshtares së sigurimit Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) të bëjë ekzekutimin e polisave nr. 122365 dhe 122366 të datës 15.02.2024, për sigurimin e garancisë së ekzekutimit të tenderit “Shërbime të përkthimit dhe pajisje të zërimit për nevoja të IAP”, me numër të prokurimit 321-24-181-2-2-1, për llot I dhe II, nr. 119153. Tutje gjykata e shkalles se pare ka arsyetuar se kërkesa e paraqitur nga ana e propozuesit për caktimin e masës, përmes ndalimit të ekzekutimit të garancionit, nuk ka ndërlidhshmëri me kërkesën kryesore sipas kërkesëpadisë përmes së cilës kërkohet kompensimi i dëmit për shkak të shkëputje së kontratës. Dhe rrjedhimisht, gjykata gjen se një masë si e tillë nuk ndjek fatin e raportit juridik

në mes të propozuesit dhe kundërpropozueses, pa marrë parasysh faktin se është propozuesi ai i cili e ka kontraktuar shumën e garancisë në favor të të paditurës, pasi që çështja apo kërkesa eventuale për ekzekutim të garancionit përbën raport juridik mes kundërshtarit të sigurimit dhe personit të tretë, e që në rastin konkret është Kompania e Sigurimeve “Elsig” dhe është e pavarur nga raport juridik i palëve në këtë procedurë. Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se propozuesi nuk e ka bërë të besueshëm rrezikun se pa caktimin e masës të njëjtit do t’i pamundësohet realizimi i kërkesës kryesore sipas padisë përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e dëmit si rezultat i shkëputjes së kontratës së lidhur mes palëve. Për më tepër, gjykata gjen se në rastin konkret, si palë e paditur paraqitet një organ shtetëror i pavarur i cili nuk mund t’i nënshtrohet ndonjë procedure të falimentimit si rezultat i së cilës do të rrezikohej apo pamundësohet realizimi i kërkesës së propozuesit sipas padisë, andaj nuk ekziston asnjë rrezik që paditësi në të ardhmen të mos mund ta realizojë kërkesën e tij për kompensim dëmi, në rast se kërkesëpadia e tij rezulton si e bazuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, Dhoma e shkallës së parë, thekson se ka ardhur në përfundim se propozuesit e masës nuk kanë arritur ta bëjnë të besueshme plotësimin kushteve ligjore siç përcaktohet me nenin 297.1 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë i pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK e po ashtu drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore i vështron gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Mbi këtë gjendje të fakteve Kolegji gjene se, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së mase se sigurisë, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit me rastin e refuzimit të propozimit. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Sipas vlerësimit të Kolegjit të Dhomës së Shkallës së Dytë, përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që nga shqyrtimi i çështjes nuk janë plotësuar në mënyrë komulative kushtet e përcaktuara me dispozitat e nenit 297 par.1 pika (a) dhe (b), e të cilat i referohen besueshmërisë së kërkesës apo të drejtës subjektive dhe ekzistimit të rrezikut se pa caktimin e masës së tillë propozuesit do të mund ti pamundësohej apo vështirësohej dukshëm realizimi i kërkesës, andaj në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar

propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Në raport me këto pretendime ankimore Dhoma e Shkallës së Dytë konstaton se në arsyetimin e aktvendimit të atakuar, në mënyrë të qartë janë dhënë kushtet ligjore që duhet përmbushur për caktimin e masës së sigurimit. Rrjedhimisht propozuesi nuk ka ofruar as fakte dhe dëshmi se ekziston mundësia e shkaktimit të dëmeve apo humbjeve të tilla, përkatësisht për cilat arsye caktimi i masës të sigurisë është i domosdoshëm. Demi konsiderohet i pariparueshëm vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me ane të një kompensimi financiar. Në fakt propozimi në masë të sigurisë, duhet të jetë i besueshëm, ashtu që kërkesa të përfshijë mundësinë e rrezikut të menjëhershëm dhe të pariparueshëm.

Kolegji i kësaj gjykate, në procedurën ankimore, në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për arsye se edhe kolegji konsideron se kërkesa e paraqitur nga ana e propozuesit për caktimin e masës, përmes ndalimit të ekzekutimit të garancionit, nuk ka ndërlidhshmëri me kërkesën kryesore sipas kërkesëpadisë përmes së cilës kërkohet kompensimi i dëmit për shkak të shkëputje së kontratës. Dhe rrjedhimisht, gjykata gjen se një masë si e tillë nuk ndjek fatin e raportit juridik në mes të propozuesit dhe kundërpropozueses, pa marrë parasysh faktin se është propozuesi ai i cili e ka kontraktuar shumën e garancisë në favor të të paditurës, pasi që çështja apo kërkesa eventuale për ekzekutim të garancionit përbën raport juridik mes kundërshtarit të sigurimit dhe personit të tretë, e që në rastin konkret është Kompania e Sigurimeve “Elsig” dhe është e pavarur nga raport juridik i palëve në këtë procedurë. Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se propozuesi nuk e ka bërë të besueshëm rrezikun se pa caktimin e masës të njëjtit do t’i pamundësohet realizimi i kërkesës kryesore sipas padisë përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e dëmit si rezultat i shkëputjes së kontratës së lidhur mes palëve. Për më tepër, gjykata gjen se në rastin konkret, si palë e paditur paraqitet një organ shtetëror i pavarur i cili nuk mund t’i nënshtrohet ndonjë procedure të falimentimit si rezultat i së cilës do të rrezikohej apo pamundësohet realizimi i kërkesës së propozuesit sipas padisë, andaj nuk ekziston asnjë rrezik që paditësi në të ardhmen të mos mund ta realizojë kërkesën e tij për kompensim dëmi, në rast se kërkesëpadia e tij rezulton si e bazuar.

Sipas vlerësimit të Dhomës së Shkallës së Dytë, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Dhoma e Shkallës së Dytë nuk i konsideroi si të bazuara pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë ka paraqitur shkelje në dëm të palës propozuesi duke mos caktuar masën e sigurisë. Përfundimisht, Dhoma e Shkallës së Dytë e ka pranuar vlerësimin dhe përfundimin e shkallës së parë, pasi që gjykata e shkallës së parë, i ka vlerësuar vetëm rrethanat nga të cilat gjykata mund të nxjerrë besueshmërinë e kërkesës apo të drejtës subjektive. Duke i marrë parasysh këto pretendime ankimore të ankuesit në ankesë, Kolegji vlerëson se te njëjtat tërësisht janë e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilat gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë se paditësit, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin ndryshe në këtë çështje juridike.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 194, 208 dhe nenit 209 pika (b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1755/24 me datë 25.09.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi d.v.